

VENDIM
Nr. 500, datë 17.7.2019

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 77, DATË 20.2.2019, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR PLANIN VJETOR TË PRANIMIT, PËR VITIN 2019, NË
INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS SHTETËRORE, PJESË TË SHËRBIMIT
CIVIL”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit nr. 77, datë 20.2.2019, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

- a) Në paragrafin e parë, shifra 495 bëhet 650;
- b) Në shkronjën “a”, shifra 8 bëhet 13;
- c) Në shkronjën “ç”, shifra 235 bëhet 385.

2. Ngarkohet Departamenti i Administratës Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama